



Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare

Fusha: Shkencat e natyrës

Konceptet e përgjithshme të fushës kurrikulare Shkencat e natyrës janë:

- Materia, vetitë dhe shndërrimet
- Proceset fizike
- Bota e gjallë
- Toka, mjedisi dhe Gjithësia

Materia, vetitë dhe shndërrimet

Në këtë nivel përfshin analizën e strukturës së atomit (konfiguracionin elektronik, numrat kuantikë), vetive periodike të elementeve (energji e jonizimit, afiniteti ndaj elektronit, elektronegativiteti, radiusi atomik), strukturës së molekulës dhe lidhjeve kimike (jonike, kovalente, polare, hidrogjenore), acideve dhe bazave, reaksioneve kimike dhe faktorëve që ndikojnë në shpejtësinë e tyre, ekuilibrave kimikë, reaksioneve elektrokimike, vetive të metaleve, jometaleve dhe gjysmëmetaleve sipas blloqeve (s, p, d, f) dhe komponimeve më të rëndësishme të tyre, komponimeve të karbonit (hidrokarburet, komponimet me oksigjen dhe azot) dhe komponimet me rëndësi jetësore (karbohidratet, lipidet, vitaminat, proteinat dhe acidet nukleike).

Proceset fizike

Kanë të bëjnë me të kuptuarit dhe zbatimin e ligjeve të lëvizjes së trupit, të bashkëveprimit gravitacional, të punës së gazeve ideale, fluideve të energjisë së brendshme, të lëkundjeve, të valëve dhe zërit, të ligjeve të elektricitetit, të magnetizmit, të ligjeve të përhapjes drejtvizore dhe të trajtimit valor të dritës, të strukturës së bërthamës, të rrezatimit, të relativitetit, të fizikës së gjendjes së ngurtë me qëllim të ngritjes së kualitetit të jetës së njeriut.

Bota e gjallë

Ka të bëjë me proceset jetësore që përfshijnë analizimin dhe aplikimin e funksionimit të botës së gjallë, proceset metabolike, përshtatshmëritë dhe adaptimet e qenieve të gjalla, proceset e trashëgimisë të njeriut dhe variabilitetit gjenetik, bioteknologjia, evolucioni dhe seleksionimi natyror, mjedisi jetësor dhe shëndeti.

Toka, mjedisi dhe gjithësia

Trajton njohuritë dhe konceptet bazë mbi: origjinën, përbërjen, lëvizjen e trupave qiellorë në hapësirë. Pozicionin e Tokës në Sistemin Diellor, marrëdhëniet Diell-Tokë-Hënë (formimit të ditë-natës, stinëve, baticës e zbaticës, eklipset, fazave të Hënës etj.), karakteristikat e Diellit dhe roli i tij për jetën në Tokë, karakteristikat e planetëve dhe trupave të tjerë brenda këtij sistemi. Toka është pjesë e këtij Sistemi, që përbëhet nga pjesë të cilat kanë marrëdhënie hapësinore dhe kohore me të. Gjithashtu ka të bëjë me njohjen dhe të kuptuarit e pikave, vijave,

harqeve, rrafshëve dhe rrafshëve themelore në sferën qiellore, me rrotullimin e dukshëm të saj, të lëvizjes së dukshme të Diellit nëpër ekliptikë, të lëvizjes së dukshme dhe të vërtetë të planetëve, të largësive dhe madhësive të trupave qiellorë, të instrumenteve për matje të madhësive astrofizike, të lindjes, zhvillimit dhe evolucionit të yjeve, të burimeve të energjisë së Diellit dhe kosmologjisë.

Raportin e njeriut dhe mjedisit, për lidhjet dhe ndikimet e tyre të ndërsjella, shkaktarët që ndikojnë në dëmtimin e mjedisit dhe masat për mbrojtjen e tij. Gjithashtu, përfshin edhe vetëdijesimin dhe angazhimin për nevojën e ruajtjes së mjedisit, të ekosistemeve dhe biodiversitetit për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm. Paraqitjen e sipërfaqes së Tokës në rrafsh (hartë), sistemet fizike – gjeosferat, ndërveprimin njeri/mjedis, rreziqet dhe resurset natyrore (përfshirë trashëgiminë natyrore dhe kulturore), sistemet humane (popullsinë, vendbanimet dhe veprimtaritë ekonomike), rajonet (regjionet) – kontinentet, Kosovën dhe vendeve përreth. Nxënësit duhet të nxiten që të krijojnë shprehitë për ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e ambientit jetësor.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: SHKENCAT E NATYRËS

Shkalla kurrikulare 1

1. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja:

Strukturimi i mendimit shkencor për konceptet, modelet, teoritë dhe ligjet për ndërtimin e lëndës, proceseve dhe dukurive në natyrë (proceset dhe dukuritë fizike, kimike, biologjike, gjeografike në Tokë dhe Gjithësi).

Nxënësi/ja:

1. Vrojtton, përshkruan dhe krahason materialet, sipas origjinës, përbërjes, vetive, madhësisë, formës, shndërrimeve dhe përdorimit në jetën e përditshme.

2. Vrojtton dhe përshkruan karakteristikat themelore dhe nevojat jetësore të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, llojlojshmërinë biologjike, ndërveprimin e organizmave me mjedisin natyror si dhe rritjen dhe zhvillimin e tyre në mjedisin natyror.

3. Përshkruan rëndësinë e përdorimit të llojlojshmërisë dhe sasisë së ushqimit të shëndetshëm, si dhe kujdeset për higjienën personale

4. dallon gjendjen e qetësisë nga gjendja e lëvizjes së trupave, përshkruan lloje të ndryshme të lëvizjeve duke i vendos në lidhmëri me veprimin e forcave.

5. Identifikon burimet e ndryshme të energjisë (duke përfshirë rolin e nxehtësisë së diellit për jetën në Tokë) për shfrytëzimin efikas të tyre për jetën e njeriut.

6. Identifikon mënyrat e orjentimit dhe lëvizjet në hapësirë, dhe tregon forma të thjeshta të bashkëveprimit në relacionin njeri-natyrë, dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit që shkaktohen nga faktorë të ndryshëm në rrethin ku jeton e më gjërë, tregon për rolin që ka në ruajtjen e mjedisit dhe ndërmerr veprime të dobishme që promovojnë mjedisin e pastër:

7. Përshkruan veçoritë e elementeve natyrore të mjedisit natyror (relivin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore).

2. Zhvillimi i shkathtësive të kërkimit shkencor për ndërtimin e lëndës, proceseve dhe dukurive në natyrë.

Nxënësi/ja:

1. formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij

2. Përdorë të gjitha shqisat, të ndara apo të kombinuara për të shpjeguar qeniet e gjalla, objektet dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij

3. Kryen prova të thjeshta ku problemi, materialet dhe metoda përzgjedhen nga mësuesi/ja

4. Grupon dhe klasifikon objektet sipas karakteristikave të vëzhgueshme (ngjyra, forma, madhësia, të ushqyerit)

5. Sugjeron përgjigje për pyetje të ndryshme, duke u bazuar në vëzhgim

6. Grumbullon dhe mban shënime të cilat i ndihmojnë për të arritur deri tek përgjigjet

7. Prezanton të dhënat (të gjeturat) duke përdor fotografi, vizatime, modele dhe metoda tjera.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: SHKENCAT E NATYRËS

Shkalla kurrikulare 2

1. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja:

Strukturimi i mendimit shkencor për konceptet, modelet, teoritë dhe ligjet për ndërtimin e lëndës, proceseve dhe dukurive në natyrë (proceset dhe dukuritë fizike, kimike, biologjike, gjeografike në Tokë dhe Gjithësi).

Nxënësi/ja:

1. Identifikon dhe hulumton materialet natyrore dhe artificiale që përdoren në jetën e përditshme sipas vetive dhe shndërrimeve të tyre.
2. Përshkruan dhe hulumton tiparet themelore të ndërtimit dhe funksionit të organizmit të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, ciklin jetësor të qenieve të gjalla, proceset riprodhuese të bimëve dhe shtazëve, zinxhirët e ushqimit dhe rolin e mikroorganizmave në mjedis.
3. Shpjegon mënyra të ruajtjes së ushqimeve, konsumimin e sigurt të tyre dhe efektet e substancave të dëmshme për organizmin (duhani, alkooli, pijet energjike).
4. Mat me instrumente përkatëse dhe sqaron ndërrimin e temperaturës gjatë ditës, natës, stinëve të vitit dhe gjendjen agregate të lëndëve.
5. Përshkruan bashkëveprimin e trupave, të lëndëve dhe të qenieve të gjalla.
6. Përshkruan pozitën e Tokës në Sistemin diellor, lëvizjet e Tokës, diellit, Hënës, dhe trupave tjerë të këtij sistemi, elementet e hartës, përmbajtjen e hartës, legjendën e hartës, shenjat hartografike, skicën, planin, globin, veçoritë e elementeve natyrore të mjedisit natyror (relinin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore), bashkëveprimin njeri/natyrë rreziqet natyrore, resurset natyrore e objektet e trashëgimisë natyrore në veçanti ato të republikës së Kosovës.

2. Zhvillimi i shkathtësive të kërkimit shkencor për ndërtimin e lëndës, proceseve dhe dukurive në natyrë.

Nxënësi/ja:

1. formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij dhe ndërlidhjen mes tyre
2. Ofron sugjerime (hipoteza) të bazuara në vëzhgim për rezultatet e mundshme të hulumtimit
3. Kryen vëzhgime sistematike dhe mban shënime gjatë matjeve me njësi standarde përmes pajisjeve (veglave) të ofruara nga mësuesi/ja
4. Përdor rezultatet e hulumtimit për të arritur përfundime (konkluzione)
5. Prezanton të dhënat (të gjeturat) dhe konkluzionet duke përdor shpjegimet me gojë dhe me shkrim, diagramet dhe grafiqet apo TIK-un.
6. Identifikon ngjashmëritë dhe dallimet që ndërlidhen me idetë dhe proceset shkencore.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: SHKENCAT E NATYRËS

Shkalla kurrikulare 3

1. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE PËRMES PROCESIT TË TË NXËNIT:

1. Zhvillimi i shkathtësive të kërkimit shkencor për ndërtimin e materies, proceseve dhe dukurive në natyrë.
2. Strukturimi i mendimit shkencor për konceptet, modelet, teoritë dhe ligjet për ndërtimin e materies, proceseve dhe dukurive në natyrë (proceset dhe dukuritë fizike, kimike, biologjike në Tokë dhe Gjithësi)

2. Shkathtësitë hulumtuese në shkenca

1. I kushton kujdes saktësisë, precizitetit dhe produktit gjatë punës.
2. Ofron hipoteza të bazuara në një numër vëzhgimesh dhe të dhëna të vlefshme
3. Propozon ide ose teori të thjeshta të cilat mund të demonstrohen me eksperimentet.
4. Grumbullon informata dhe të dhëna nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë klasës dhe nga TIK-u.
5. Zabton rregullat e sigurisë gjatë punës praktike (duke përfshi edhe shenjat e rrezikut).
6. Prezanton shpjegime të arsyeshme, duke përfshi të dhënat nga parashikimet dhe hipotezat.

3. Materia, vetitë dhe shndërrimet

1. Dallon dhe klasifikon lëndët sipas përbërjes, strukturës, vetive fizike dhe kimike, shndërrimeve dhe përdorimit të tyre në jetën e përditshme.

4. Bota e gjallë

1. Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.
1. Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësor të njeriut.

5. Proceset fizike

1. Përshkruan vetitë e lëndës, lëvizjen, forcat e bashkëveprimit energjinë dhe shndërrimet e saja, ligjet e ruajtjes, lëvizjen kinetike dhe termike me qëllim të ngritjes së njohurive shkencore.

6. Toka, mjedisi dhe Gjithësia

1. Shpjegon përbërjen e litosferës, hidrosferës, atmosferës, biosferës, proceset në to dhe ndërrimet e thjeshta të pozitës së trupave gjatë kohës.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: SHKENCAT E NATYRËS

Shkalla kurrikulare 4

1. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE PËRMES PROCESIT TË TË NXËNIT:

1. Zhvillimi i shkathtësive të kërkimit shkencor për ndërtimin e materies, proceseve dhe dukurive në natyrë.
2. Strukturimi i mendimit shkencor për konceptet, modelet, teoritë dhe ligjet për ndërtimin e materies, proceseve dhe dukurive në natyrë (proceset dhe dukuritë fizike, kimike, biologjike në Tokë dhe Gjithësi)

2. Shkathtësitë hulumtuese në shkenca

1. Vlerëson rrezikun para fillimit të punës praktike nga mjedisi dhe mjetet të cilat I përdorë.
2. Planifikon dhe kryen eksperimente të thjeshta me dy-tre ndryshore (variabla) dhe i kontrollon ato për të arritur rezultatet e detyrës.
3. Identifikon mënyra të ndryshme të qasjes së problemit dhe krahason rezultatet e provave të ndryshme.
4. Përdor koncepte matematike për përpunimin dhe paraqitjen e rezultateve.
5. Prezanton konkluzionet e hulumtimit/ eksperimentit duke i arsyetuar me dëshmi të mjaftueshme.

3. Materia, vetitë dhe shndërrimet

1. Përshkruan dhe analizon elementet kimike që hyjnë në përbërjen e komponimeve inorganike dhe organike, strukturën e këtyre komponimeve, vetitë fizike e kimike, funksionimin dhe ndërlidhjen e tyre në botën e gjallë dhe jo të gjallë dhe ndikimin e tyre afatgjatë në mjedis.

4. Bota e gjallë

1. Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke ju referuar biodiversitetit të qenjeve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.
2. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogaritë nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.

5. Proceset fizike

1. Shpjegon burimet e energjisë, format dhe shndërrimet e valëve mekanike, të zërit, ligjeve elektrike dhe magnetike, burimeve të dritës, relativitetit të levizjeve, strukturës së bërthamës, radioaktivitetit të saj, me qëllim të shfrytëzimit të tyre në jetën e përditshme.

6. Toka, mjedisi dhe Gjithësia

1. Analizon përbërësit e ndërtimit të kores së Tokës, resurset natyrore e në veçanti ato të Republikës së Kosovës dhe lidhshmërinë hapësirë-kohë, tregon lëvizjen e dukshme dhe të vërtetë, ndërtimin e sistemit diellor dhe të galaktikave.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: SHKENCAT E NATYRËS

Shkalla kurrikulare 5

I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE PËRMES PROCESIT TË TË NXËNIT:

1. Shkathtësitë hulumtuese në shkencë - Zhvillimi i shkathtësive të kërkimit shkencor për ndërtimin e materies, proceseve dhe dukurive në natyrë.

1. Përdor teoritë shkencore për të zhvilluar hipoteza

2. Planifikon dhe realizon eksperimente për të kryer observime, testuar hipoteza apo shpjeguar fenomene

3. Zbaton ciklin e grumbullimit dhe analizimit të dhënave gjatë hulumtimit

4. Prezanton të dhënat nga hulumtimi duke zgjedhur metodat dhe gjuhën adekuate shkencore

5. Demonstron kujdes, shkathtësi dhe precizitet gjatë punës praktike

2. Strukturimi i mendimit shkencor për konceptet, modelet, teoritë dhe ligjet e ndërtimit të materies, të proceseve dhe dukurive në natyrë (Proceset dhe dukuritë fizike, kimike, biologjike dhe gjeografike në Tokë dhe në Gjithësi)

2.1. Materia, vetitë dhe shndërrimet

1. Analizon strukturën e atomit, të molekulës, të joneve, përbërjen, rëndësinë, vetitë fizike dhe kimike të elementeve, komponimet dhe reaksionet ndërmjet tyre si dhe demonstron disa prej tyre.

2. Analizon përbërjen, ndërtimin dhe vetitë e substancave, ndikimin e elementeve, komponimeve inorganike e organike në botën e gjallë dhe jo të gjallë në përmisimin e cilësisë së jetës.

2.2. Bota e gjallë

1. Analizon dhe hulumton llojllojshmërinë e botës së gjallë si rezultat i evolucionit, rolin e ADN-së në trashëgimi dhe proceset biokimike në qelizë, biologjinë e pesë mbretërive të qenieve të gjalla dhe zbatimin e ligjshmërisë së ndërtimit dhe funksionit të sistemeve të gjalla në bioteknologji dhe teknikë.

2. Vlerëson ndikimin e barnave dhe drogave në sjelljen dhe shëndetin e njerëzve, ndërlidhjen e shëndetit me sëmundjet, zvogëlimin dhe parandalimin e sëmundjeve të ndryshme (duke përfshirë edhe sëmundjet e transmetueshme seksualisht).

3. Analizon llojllojshmërinë e botës së gjallë si rezultat i evolucionit, ADN dhe trashëgimia, proceset bio-kimike në qelizë.

4. Vlerëson ndikimin e barnave dhe drogave në sjelljen dhe shëndetin e njerëzve, ndërlidhjen e shëndetit me sëmundjet, zvogëlimin dhe parandalimin e sëmundjeve të ndryshme (duke përfshirë edhe sëmundjet e transmetueshme seksualisht).

2.3. Proceset fizike

1. Shpjegon ligjin e ruajtjes së energjisë në proceset natyrore, energjinë e brendshme, ndërrimet e saja në trupat e ngurtë dhe fluide, rregullin, kaosin, ciklet dhe lidhshmërinë e nxehtësisë me temperaturën

2. Në mënyrë analitike, grafike dhe me numra paraqet rregullat e bashkëveprimeve

themelore gravitacionale dhe elektromagnetike.

3. Përdor terminologjinë shkencore në shpjegimin e proceseve në natyrë, përmes katër bashkëveprimeve themelore.

2.4.Toka, mjedisi dhe Gjithësia

1. Analizon pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, lëvizjet e Tokës, Diellit, Hënës, planeteve dhe trupave tjerë të këtij sistemi, formën, përmasat e Tokës dhe paraqitjen e sipërfaqes së Tokës në glob dhe hartë.

2. Shpjegon përbërjen, ndërtimin, strukturën dhe dinamikat e gjeosferave - litosferës, atmosferës, hidrosferës, biosferës, dukuritë dhe proceset që ndodhin në to, marrëdhëniet ndërvepruese ndërmjet komponentëve të gjeosferave, veçoritë e popullsisë, vendbanimeve dhe veprimtarive ekonomike në nivel lokal, regjional dhe ndërkombëtar.

3. Analizon pozitën gjeografike, karakteristikat natyrore (relievit, klimës, ujërave, tokave dhe botës bimore e shtazore) dhe socio-ekonomik (popullsisë, vendbanimeve veprimtarive ekonomike) dhe të regjioneve (rajoneve) – kontinenteve dhe vendeve të ndryshme të botës

4. Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, lëvizjet e Tokës, Diellit, Hënës, planeteve dhe trupave tjerë të këtij sistemi, formën, përmasat e Tokës dhe paraqitjen e sipërfaqes së Tokës në hartë dhe glob;

5. Analizon përbërjen, ndërtimin, strukturën dhe dinamikat e gjeosferave - litosferës, atmosferës, hidrosferës, biosferës, dukuritë dhe proceset që ndodhin në to, veçoritë e popullsisë, vendbanimeve dhe veprimtarive ekonomike në nivel lokal, regjional dhe ndërkombëtar;

6. Analizon veçoritë e pozitës gjeografike, kushteve natyrore (relievit, klimës, ujërave, tokave dhe botës bimore e shtazore) dhe socio-ekonomike (popullsisë, vendbanimeve veprimtarive ekonomike), rolin e resurseve natyrore në mjedisi dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe vendeve përreth.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS: SHKENCAT E NATYRËS

Shkalla kurrikulare 5

I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE PËRMES PROCESIT TË TË NXËNIT:

1. Zhvillimi i shkathtësive të kërkimit shkencor për ndërtimin e materies, proceseve dhe dukurive në natyrë.
2. Strukturimi i mendimit shkencor për konceptet, modelet, teoritë dhe ligjet për ndërtimin e materies, të proceseve dhe dukurive në natyrë (proceset dhe dukuritë fizike, kimike, biologjike dhe gjeografike, në Tokë dhe në Gjithësi).

1. Shkathtësitë hulumtuese në shkenca - Zhvillimi i shkathtësive të kërkimit shkencor për ndërtimin e materies, proceseve dhe dukurive në natyrë.

1. Përdor fjalor të pasur shkencor gjatë shpjegimit të dukurive në natyrë
2. Vlerëson të dhënat e grumbulluara gjatë hulumtimit si nga saktësia ashtu edhe besueshmëria
3. Përzgjedh teknikat, aparaturat dhe materialet adekuate për punë praktike

2.Strukturimi i mendimit shkencor për konceptet, modelet, teoritë dhe ligjet e ndërtimit të materies, të proceseve dhe dukurive në natyrë (Proceset dhe dukuritë fizike, kimike, biologjike dhe gjeografike në Tokë dhe në Gjithësi)

2.1. Materia, vetitë dhe shndërrimet

1. Analizon dhe hulumton përbërjen dhe vetitë e komponimeve organike që gjenden në botën e gjallë dhe jo të gjallë si dhe ato të krijuara nga njeriu (materialet sintetike) dhe analizon ndërlidhjen e tyre në proceset jetësore për një mjedis të qëndrueshëm

2.2. Bota e gjallë

1. Vlerëson (gjykon) ndërlidhjet funksionale të strukturave qelizore gjatë proceseve jetësore të njeriut; biologjinë e njeriut dhe format bashkëkohore të mbrojtjes së shëndetit të njeriut.
2. Organizon aktivitete për vetëdijësimin e të tjerëve rreth shëndetit seksual dhe substancave të cilat rrezikojnë shëndetin e njeriut.

2.3.Proceset fizike

1. Shpjegon ligjet e bashkëveprimeve themelore në natyrë; të dobët dhe të fuqishëm bërthamor, ndikimin e tyre në jetën e njeriut dhe ndotjen e mjedisit.
2. Shpjegon lidhshmërinë e resurseve energjetike me ndotjen e mjedisit jetësor dhe vlerëson trendët e zbulimit të energjisë së pastër.

2.4.Toka, mjedisi dhe Gjithësia

1. Analizon veçoritë e pozitës gjeografike, kushteve natyrore (relievit, klimës, ujërave, tokave dhe botës bimore e shtazore) dhe socio-ekonomike (popullsisë, vendbanimeve veprimtarive ekonomike), rolin e resurseve natyrore dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe vendeve përreth.

2. Analizon lidhjet shkak-pasojë për një situatë problemore në Kosovë, duke evidentuar tiparet e ndërveprimit të njeriut në mjedis dhe debaton masat që duhet të ndërmerren për të mbrojtur mjedisin nga ndotja.

3. Vlerëson sistemin gjeocentrik dhe heliocentrik, lëvizjen e dukshme të Diellit, rrjedhojat e saj, teoritë bashkëkohore të krijimit të sistemit diellor dhe shpjegon lidhshmërinë e hapësirë – kohës në krijimin e Gjithësisë në procesin e Eksplozimit të Madh.